
KOMUNA E JEGUNOVCIT



FLETORJA ZYRTARE
E KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

Botohet sipas nevojës	**Numër 50**	**30.01.2025**

JEGUNOVC, J A N A R 2025

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin IV-të të vitit 2024

Shpallet Konkluzioni për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin IV-të të vitit 2024 ,që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/1
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit",nr. 21/03), kurse në pajtim me nenin 32 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 61/04), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetë të mbajtur më 30.01.2025, mori

KONKLUZION

për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin IV-të të vitit 2024

1. Miratohet Raporti financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin IV-të të vitit 2024.

2. Ky Konkluzion hyn në fuqi ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-160/3
30.01.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d. v .

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Programit për punën e Këshillit të Jegunovcit për vitin 2025

Shpallet Programi për punën e Këshillit të Jegunovcit për vitin 2025 ,që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/ 2
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 pika 6 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (''Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 5/2002),nenit 21 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit(''Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit'' nr. 21/03) , Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetë të mbajtur më 30.01.2025 ,mori

P R O G R A M

për punën e Këshillit të Jegunovcit për vitin 2025

I. Materiale nga kompetencat burimore të komunës

1. Programi për punën e Këshillit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025.
2. Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.
3. Programi për ndërtimin e udhëve komunale dhe rrugëve për vitin 2025
4. Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025 rishikim.
5. Vendimi për ndryshimin –zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2025
6. Raporti financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024 për kuartalin e IV dhe për 2025 për tremujorin I,II dhe III.
7. Plani operativ për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve komunale nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit për vitin 2025
8. Planet vjetore për punën e shkollave fillore nga territori i Komunës së Jegunovcit për vitin 2025/2026.
9. Raportet vjetore për punën e shkollave fillore nga territori i Komunës së Jegunovcit për vitin 2024/2025
10. Buxheti i Komunës së Jegunovcit për vitin 2026.
11. Miratimi i programeve për punë, raporte financiare dhe llogaritë përfundimtare për shërbimet publike, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë të themeluara nga komuna për vitin 2025.

II. Dokumente për planifikimin zhvillimorë

1. Vendime për financimin e projekteve,dokumente zhvillimore dhe nevoja të tjera për zhvillimin e komunës dhe në interes të qytetarëve

III. Çështje të cilat shqyrtohen sipas nevojës

IV. Puna e trupave punues të Këshillit

V. Aktivitete të tjera

PROGRAMI

Për punën e Këshillit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025

1. Këshilli i Komunës së Jegunovcit në periudhën prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025 punën e vetë do ta drejtojë kah realizimi i kompetencave burimore të përcaktuara me Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës së Jegunovcit por edhe Ligje të cilët e rregullojnë materien nga lëmi i vetëqeverisjes lokale.

Përveç çështjeve nga kompetencat burimore Këshilli i Komunës së Jegunovcit do të shqyrtojë edhe çështje të cilat do të dalin nga bashkëpunimi i ndërsjellë me organet shtetërore,të cilat janë aktuale dhe me rëndësi të veçantë për Komunën e Jegunovcit.

2. Në mbledhje të Këshillit do të shqyrtohen këto materiale:

I. Materiale nga kompetencat burimore të komunës

1. Programi për punën e Këshillit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025.
   Propozues: Kryetari i Këshillit
   Përgatitës: Administrata komunale
   Afati:Janar-Shkurt

2. Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.
   Propozues:Kryetari i komunës
   Përgatitës: Njësia për çështje financiare
   Afati:Shkurt-Mars 2025

3. Programi për ndërtimin e udhëve komunale dhe rrugëve për vitin 2025.
   Propozues: Kryetari i komunës
   Përgatitës: Administrata komunale
   Afati:Shkurt-Maj 2025

4. Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025-rishikim.
   Propozues: Komisioni për financim,Buxhet dhe ZHEL
   Përgatitës: Njësia për çështje financiare
   Afati:Sipas nevojës

5. Vendimi për ndryshimin –zgjerimin e mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2025.
   Propozues:Komisioni për financim,Buxhet dhe ZHEL
   Përgatitës: Njësia për çështje financiare
   Afati:Sipas nevojës

6. Kalendari Buxhetor i Komunës së Jegunovcit për vitin 2026
   Propozues:Komisioni për financim,Buxhet dhe ZHEL
   Përgatitës: Njësia për çështje financiare
   Afati:Qershor –Gusht 2025

7. Raporti financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2025 për tremujorin I,II dhe III.

Propozues:Komisioni për financim,Buxhet dhe ZHEL
Përgatitës: Njësia për çështje financiare
Afati:Prill-Korrik-Tetor 2025

8. Plani operativ për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve komunale nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit.

Propozues: Kryetari i komunës
Përgatitës: Administrata komunale
Afati:Shtator-Tetor 2025

9. Planet vjetore për punën e shkollave fillore nga territori i Komunës së Jegunovcit për vitin 2025/2026.

Propozues: Komisioni për veprimtari shoqërore
Përgatitës: Shkollat fillore
Afati:Shtator 2026

10. Raportet vjetore për punën e shkollave fillore nga territori i Komunës së Jegunovcit për vitin 2024/2025.

Propozues: Komisioni për veprimtari shoqërore
Përgatitës: Shkollat fillore
Afati:Shtator 2025

11. Buxheti i Komunës së Jegunovcit për vitin 2026.

Propozues:Kryetari i komunës
Përgatitës: Njësia për çështje financiare
Afati:Dhjetor 2025

II. Dokumente për planifikimin zhvillimor

1. Vendime për financimin e projekteve,dokumenteve zhvillimore dhe nevojave për për zhvillimin e komunës me interes për qytetarët

Propozues: Kryetari i komunës
Përgatitës: Administrata komunale
Afati:Sipas nevojës dhe vlerësimit të kryetarit të komunës dhe organeve të tjera të komunës.

III. Çështje të cilat shqyrtohen sipas nevojës

1. Informacione lidhur me ndriçimin publik;
2. Raporte lidhur me përmbytje dhe zjarre;
3. Miratimi i planeve urbanistike për vendbanimet,për një pjesë të vendbanimeve ose ndryshime të Planit të përgjithshëm urbanistik,planeve detaje urbanistike dhe dokumentacioneve urbanistike për vendbanimet;
4. Informacione varësisht nga aktualiteti i ndonjë problemi të caktuar për zgjidhjen e tij.

IV. Puna e trupave punues të Këshillit

Trupa punues të përhershëm të Këshillit të Komunës

-Komisioni për çështje të mandatit,zgjedhjeve dhe emërimeve;
-Komisioni për financim,Buxhet dhe ZHEL;
-Komisioni për Statut dhe dispozita;
-Komisioni për urbanizëm,veprimtari botore dhe mbrojtje të mjedisit jetësor;
-Komisioni për veprimtari shoqërore;
-Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive;
-Komisioni për mundësi të barabarta.

Aktivitetet dhe detyrat e veta do t'i kryejnë në pajtim me kompetencat e parapara me Ligjin për Vetëqeverisje lokale,Statutin dhe Rregulloren,secili për lëmin e vetë si përpunim paraprak të materialeve për mbledhje dhe materiale të tjera për nevojat e Këshillit gjegjësisht organeve të tjera.

V. Aktivitete të tjera

Këshilli i Komunës së Jegunovcit,kryetari i komunës dhe komisionet gjatë vitit 2025 do të ndërmarrin masa dhe aktivitete edhe për çështje të tjera aktuale varësisht nga aktualiteti dhe nevoja e tyre.

VËREJTJE: Afatet e parapara në këtë Program për realizimin e tyre,munden të ndryshojnë sipas nevojës nga aktualiteti i ndonjërit problem për zgjidhje,sipas vlerësimit të kryetarit të komunës, Këshillit dhe komisioneve dhe mund të programohen edhe aktivitetet të tjera varësisht nga aktualiteti i tyre.

Nr. 08-160/4
30.01.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Perica Saveski d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Kritereve për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025

Shpallen Kriteret për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025,që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/ 3
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të Ligjit për tatimin në pronë („Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 61/04, 92/07,102/08,35/11,53/11, 84/12, 188/13, 154/15, 192/15 dhe 23/16) dhe Metodologjisë për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme („Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 54/12,17/13,21/13 dhe 142/14) dhe nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 5/02), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetë të mbajtur më 30.01.2025 i caktoi çmimet minimale të tokës ndërtimore të caktuara në bazë të çmimeve të arritura në qarkullim në vitin 2024 të cilat do të shfrytëzohen për vlerësimin e pronës së patundshme në Komunën e Jegunovcit dhe zonat për vendbanimet të cilat i përkasin Komunës së Jegunovcit

K R I T E R E T

për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025

A. TOKA BUJQËSORE

Klasa kad.	KOMUNA KADASTRALE	
	Arrë, kopsht, kopsht pemësh, çmimi den/m²	livadh, vreshta, pyje, kullota etj. çmimi den./m²
1	200	130
2	180	120
3	160	110
4	140	100
5	120	90
6	100	80
7	90	70
8	80	60

B. TOKË NDËRTIMORE

KOMUNA KADASTRALE	Tokë ndërtimore çmimi për m²
Jegunovc , Vratnicë, Podbreg dhe Kopanicë	900
Zhillçë, Siriçinë, Shemshovë, Prelubishtë, Jançishtë, Staro Sellë, Orashë, Tudencë, Ratajë, Jazhincë, Rogaçevë dhe Raotincë	850
Bellovishtë	800

KOMUNAT KADASTRALE	VENDBANIMET
	Jegunovc, Vratnicë, Zhillçë, Shemshovë, Prelubishtë, Ratajë, Siriçinë, Jançishtë, Kopanicë, Bellovishtë, Podbreg, Raotincë, Tudencë, Jazhincë, Orashë, Rogaçevë dhe Staro Sellë.

B. ZONAT E PËRCAKTUARA

Zonë e caktuar	I përgjigjet zonës nga metodologjia	pika
zonë e I-rë	zona e XV	40

Zonë e caktuar	Vendbanimet
zonë e I-rë	Jegunovc, Vratnicë, Zhillçë, Shemshovë, Prelubishtë, Ratajë, Siriçinë, Jançishtë, Kopanicë, Bellovishtë, Podbreg, Raotincë, Tudencë, Jazhincë, Orashë, Rogaçevë dhe Staro Sellë.

Neni 2

Vlera e tregut e tokës bujqësore,pyjeve dhe kullotave përcaktohet sipas çmimit mestar të shitblerjeve të kryera në vitin paraprak në vitin që i paraprinë për të cilin bëhet vlerësimi i tatimit në pronë

Neni 3

Vlera e tregut e tokës ndërtimore përcaktohet sipas çmimit mestar të shitblerjeve të kryera në vitin paraprak në vitin që i paraprinë për të cilin bëhet vlerësimi i tokës.

Neni 4

Baza tatimore për tatim në qarkullim të pronës së patundshme, baza tatimore për tatim në qarkullim me kontratë për përkujdesje të përjetshme dhe baza tatimore për tatim në trashëgimi dhe dhurata në mes të trashëgimtarëve të brezit të parë dhe të dytë trashëgues zvogëlohet për 50% të shumës së caktuar.

Neni 5

Vlera e tregut e pasurisë së patundshme si vlerë e pasurisë e cila mund të arihet në qarkullimin e lirë në çastin e aritjes së detyrimit tatimor përcaktohet për pasurinë e patundshme në vijim edhe atë:

1. Ndërtesa
a. ndërtesa banesore dhe banesa(bodrume, ballkone, logji dhe taraca)
b. ndërtesa afariste dhe lokale afariste,
c. ndërtesa afariste dhe hapësira afariste
d. ndërtesa dhe banesa për pushim dhe rekrejim

2. Toka
a. bujqësore
b. ndërtimore pyje dhe
c. kullota.

3. Objekte tjera ndërtimore
a. garazhe
b. objekte ndihmëse (hambarë, stalla, kasolla).
c. pasuri tjetër të patundshme.

Neni 6

Vlera e tregut e pasurisë së patundshme nga neni 5 i këtyre Kritereve përcaktohet me pika përllogaritës për m^2 sipërfaqe funksionale për ndërtesat dhe objektet e tjera ndërtimore dhe për metër 2 për sipërfaqe të tokës, varësisht nga lloji i pronës dhe sipas elementeve shtesë themelore dhe plotësuese të përfshirë në këto kritere dhe në formularët të cilët janë pjesë e kësaj metodologjie.

Neni 7

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore kolektive përllogaritet si mbledhje e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logji dhe 30% të sipërfaqeve të bodrumit.

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore kolektive e cila gjendet në nënkulm paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logji dhe 30% të sipërfaqeve të bodrumit.

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore individuale (shtëpi) paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logjive.

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore individuale(shtëpi) e cila gjendet në nënkulm paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logjive.

Sipërfaqja funksionale e bodrumit dhe suterenit në ndërtesat banesore individuale(shtëpi) paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë ndërmjet mureve të brendshme.

Sipërfaqja funksionale përcaktohet sipas dokumentacionit gjegjëse por nëse të tillë nuk ka atëherë me matje.

Neni 8

Kriteret për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit hynë në fuqi në ditë e shpalljes në „ Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit''.

Nr. 08-160/5
30.01.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Perica Saveski, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Kritereve për shpërndarjen e bllok dotacioneve për arsimin fillor për shkollat në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2025

Shpallen Kriteret për shpërndarjen e bllok dotacioneve për arsimin fillor për shkollat në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2025 ,që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/ 4
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 162 dhe nenit 166 paragrafi 3 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 103/08, 33/10.....67/17) dhe nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetë të mbajtur më 30.01.2025 miratoi,

K R I T E R E T

për shpërndarjen e bllok dotacioneve për arsimin fillor për shkollat në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2025

Neni 1

Shpërndarja e bllok dotacioneve për arsimin fillor në shkollat fillore komunale në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2025 bëhen sipas kritereve në vijim:

Numri i të punësuarve
Numri i nxënësve
Numri i paraleleve
Numri i shkollave territoriale dhe
Të dalat e planifikuara vjetore rrjedhëse.

Neni 2

Këto Kritere hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-160/6
30.01.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d. v .

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për formimin e Komisionit për selektim për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP "Rusino – Pollog"

Shpallet Vendimi për formimin e Komisionit për selektim për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP "Rusino – Pollog" ,që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/ 5
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 17 dhe 26-a të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18, 35/19 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 275/19 89/22 dhe 274/22), nenit 36 paragrafi 5 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 5/02), me propozim të kryetarit të Komunës së Jegunovcit, Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025, miratoi:

V E N D I M

për formimin e Komisionit për selektim për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP "Rusino – Pollog"

Neni 1

Me këtë Vendim, Këshilli i Komunës së Jegunovcit, formon Komision për selektim për zgjedhje të anëtarit të Këshillit drejtues të NPP "Rusino"- Pollog, edhe atë:

1. Kryetar i komisionit-Anita Kostadinoska
2. zëvendës kryetar-Stojançe Antovski
3. anëtar-Daniel Gjorgjevski
4. zëvendës anëtar-Ilço Jovanovski
5. anëtar-Genc Sadini
6. zëvendës anëtar-Zulejha Taravari

Neni 2

Komisioni për selektim do të përgatisë Thirje publike për paraqitjen e personave të interesuar për anëtar të Këshillit drejtues të NPP "Rusino" - Pollog, të cilin në emër të Këshillit të Komunës së Jegunovcit, do të shpallë kryetari i Këshillit të Komunës së Jegunovcit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-160/7
30.01.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Programit për punimin e planeve urbanistik për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve për vitin 2025

Shpallet Programi për punimin e planeve urbanistik për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve për vitin 2025 ,që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/ 6
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 20 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/1664/18 dhe 168/18) dhe neni 22 paragrafi 1 pika 1 dhe neni 50 paragrafi 1 pika 6, neni 62 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 5/02) me propozim të kryetarit të Komunës së Jegunovcit, Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetë të mbajtur më 30.01.2025 miratoi

PROGRAM

për punimin e planeve urbanistik për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve për vitin 2025

Neni 1

Bazë për punimin e planeve urbanistik për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve është Plani hapësinor i R. Maqedonisë, planet detaje urbanistike të vlefshme të Komunës së Jegunovcit, planet urbanistike jashtë vendbanimeve.

Neni 2

Me planet urbanistik për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës me përcaktimin e parcelës ndërtimore në dhe jashtë përfshirjes planore, si dhe rregullimi i hapësirës në suaza të parcelës ndërtimore të formuar, për ndërtime të përcaktuar me Ligj si dhe ndërtime të kategorisë dytë, për shkak të realizimit të projekteve investuese me rëndësi për komunën.

Neni 3

Plane urbanistike për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planet urbanistike jashtë vendbanimeve lejohet që të punohen për vendbanimet të cilat i përkasin Komunës së Jegunovcit edhe atë për këto: Jegunovc, Vratnicë, Podbreg, Shemshovë, Zhillçë, Prelubishtë, Siriçinë,Kopanicë, Raotincë,Tudencë, Jançishtë, Ratajë, Bellovishtë, Staro Sellë, Rogaçevë , Jazhincë dhe Orashë.

Neni 4

Me punimin e Planeve urbanistike për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve do të përfshihen të gjithë parcelat kadastrale të caktuara në komunat kadastrale në pikën 3 të këtij Programi, ku do të ketë kushte të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore në sferën e urbanizmit, ndërtimtarisë, tokës ndërtimore, pronësisë, komunikacionit dhe udhëve.

Gjatë punimit dhe lejimit të Planeve urbanistike për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve të respektohet e drejta pronësore në parcelat kadastrale fqinje e cila kufizohet me parcelën kadastrale e cila është lëndë e punimit dhe lejimit të dokumentacionit planor urbanistik lokal.

Neni 5

Punimi i Planeve urbanistike për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve për parcelat kadastrale të përfshira me pjesën grafike-sipërfaqes kadastrale të vërtetuara nga neni 3, do të zgjidhen me procedurë administrative për çdo parcelë veçmas, me kërkesë të personave fizikë dhe juridikë, bashkangjitur në kërkesë të drejtën juridike për fitimin e së drejtës për pronësi, kopje të planit kadastral dhe fletëpronësisë.

Për procedurat nga paragrafi 1 i këtij neni do të zgjidhen në pajtim me dispozitat nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative.

Neni 6

Planet urbanistike për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planet urbanistike jashtë vendbanimeve të cilat e rregullojnë hapësirën në kufijtë e përfshirjes planore punohen në bazë të ekstraktit nga plani urbanistik.

Neni 7

Planet urbanistike për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planet urbanistike dhe jashtë vendbanimeve jashtë kufijve të përfshirjes planore punohen në bazë të ekstraktit nga plani hapësinor gjegjësisht kushteve për planifikim të lëshuara nga organi shtetëror, më pas pëlqim për ridestinim nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e dhënë nga Ministria e bujqësisë kompetente dhe udhë qasëse e realizuar deri te parcela kadastrale.

Neni 8

Komuna e Jegunovcit do t'i financojë planet urbanistike për vendbanimet në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe planet urbanistike jashtë vendbanimeve për objektet me interes për komunën.

Neni 9

Punimi i Planeve urbanistike për vendbanimet e territorit të Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve mund të financohet edhe nga personat fizikë dhe juridikë përderisa ata janë porositës të përgatitjes së punimit të dokumentacionit planor.

Neni 10

Kryetari i Komunës së Jegunovcit e zbaton këtë Program.

Neni 11

Ekzemplar nga ky Program i dorëzohet edhe organit të administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit hapësinor.

Neni 12

Programi hyn në fuqi në ditën e 8-të nga dita e shpalljes në „Fletoren Zyrtare të Komunës së Jegunovcit''.

Nr. 08-160/8
30.01.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski, d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Programit për punimin e projekteve urbanistike në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025

Shpallet Programi për punimin e projekteve urbanistike në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/ 7
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë te nenit 39,40,41 dhe 42 të Ligjit për planifikim urbanistik („ Gaz. zyrtare e RMV-së nr. 32/2020), neni 22,50 dhe 62 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („ Gaz. zyrtare e RMV nr. 5/02) me propozim të Kryetarit të Komunës së Jegunovcit, Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetë të mbajtur më 30.01.2025 miratoi:

PROGRAM

për punimin e projekteve urbanistike në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025

Neni 1

Projekti urbanistik është dokumentacion i plan-projektit i cili përgatitet në bazë të planeve urbanistike të nenit 10 paragrafi 1 pikat 2,3,4 dhe 5 të këtij ligji (PUD, PUF, PUJRN, shtetërore) dhe shërben për përpunimin dhe zbatimin e tyre.

Me projekte urbanistike bëhet përpunimi i detajuar i parcelave ndërtimore dhe tokës ndërtimore për përdorim të përgjithshëm për të cilat në planet urbanistike nuk janë dhënë dispozita të hollësishme për ndërtimin dhe rregullimin e tokës.

Neni 2

Varësisht nga lloji dhe dedikimi i tokës ndërtimore dhe ndërtimeve që janë lëndë, e përpunimit projekti urbanistik mund të jetë:

1. Projekt urbanistik për tokë të parceluar ndërtimore.
2. Projekt urbanistik për tokë ndërtimore për përdorim të përgjithshëm.
3. Projekt urbanistik për tokë ndërtimor, me të cilin bëhet përpunimi urbanistik-arkitektonik, ndërtimorë ose tekniko- teknologjik, përpunimi i planit-projektues të parcelave ndërtimore ose të parcelave kadastrale.
4. Projekti urbanistik për infrastrukturë.
5. Projekt urbanistik për përpunimin e planit urbanistik për fshat nga neni 14 paragrafi 2 pika 2 të Ligjit për planifikim urbanistik (Gaz. zyrtare RMV„ nr. 32/2020)

Neni 3

Me përjashtim me rastet e mëparshme, projekti urbanistik mund të përgatitet edhe për ndërtesa individuale dhe infrastrukturë të rëndësishme shtetërore dhe lokale jashtë vendbanimeve dhe jashtë përfshirjes së planit urbanistik bujqësore , të pyjeve dhe tokës tjetër zonat bregdetare dhe hapësirat tjera për të cilat nuk ka kushte dhe/ose arsyetim ekonomik për miratimin e planit urbanistik dhe përpunohet në bazë të kushteve të grumbulluara për planifikim e hapësirës plan programit të miratuar nga organi përgjegjës, mendime nga organet shtetërore institucionet dhe persona juridik.

Neni 4

Gjatë përpunimit dhe miratimit të Projektit urbanistik të respektohet e drejta e pronës së parcelave kadastrale fqinjë të cilët janë të kufizuar me parcelë kadastrale (parcela) e cila është lëndë e përpunimit dhe miratimit të të njëjtit

Neni 5

Projektin urbanistik mund ta përpilojnë personat juridik me licencë për përpilimin e planeve urbanistike sipas nenit 68 të ligjit në fjalë dhe personat juridik që i plotësojnë kushtet e projektimit.

Neni 6

Procedura për përpunimin e Projektit urbanistik fillon me iniciative të organit shtetërorë, njësia për vetëqeverisje lokale ose personi juridik që është përgjegjës për realizimin e planit dhe ndërtimit të objekteve të planifikuara si investitor sipas ligjit për ndërtim.

Neni 7

Inicuesi nga neni i mëparshëm, e financon përpunimin e projektit urbanistik , kurse pas përpunimit të tij e financon përpunimin revizioni profesional.

Neni 8

Komuna e Jegunovcit nga Buxheti i komunës do të financoi projektet urbanistike të cilat janë në interes të komunës.

Neni 9

Kryetari i Komunë së Jegunovcit e zbaton këtë program.

Neni 10

Kopje nga kjo Program dërgohet deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmia e rregullimit hapësinorë. Ky program detyrimisht duhet të shpallet në „ Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit'' ndërsa në formë elektronike edhe në ''e-urbanizëm''

Neni 11

Programi hyn në fuqi ditën e tetë (8) nga shpallja në „ Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit''.

Nr. 08-160/9
30.01.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski, d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Programit për punë në fushën e menaxhimit të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në territorin e Komuna e Jegunovcit për vitin 2025

Shpallet Programi për punë në fushën e menaxhimit të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në territorin e Komuna e Jegunovcit për vitin 2025 ,që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025.

Nr. 09-199/ 8
30.01.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 99 të Ligjit për tokën ndërtimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16 dhe 190/16 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 275/19), me propozim të kryetarit të komunës, Këshilli i Komunës së Jegunovcit, në mbledhjen e pesëdhjetë të mbajtur më 30.01.2025 , miratoi

Programi për punë në fushën e menaxhimit të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në territorin e Komuna e Jegunovcit për vitin 2025

Neni 1

Prezantimi
-Pjesa e përgjithshme
-Shtrirja hapësinore dhe lënda e Programit
-Baza ligjore
-Dokumentet bazë të planifikimit
-Personat e përfshirë në zhvillimin e Programit

Neni 2

1. Objektivat e programit:
-Objektivat e përgjithshme të programit;
-Objektivat specifike të programit në vendbanime, blloqe urbane dhe lokalitete.

2. Shtrirja dhe pasqyra e tokës ndërtimore objekt i Programit (të grupuar sipas planit urban):
-Lista e parcelave ndërtimore që do t'i nënshtrohen menaxhimit në atë vendbanim/lokacion;
-Një bashkëngjitje grafike me parcela ndërtimore të shënuara që do t'i nënshtrohen menaxhimit në atë vendbanim/lokacion;

3. Pasqyrë e detajuar e parcelave ndërtimore (të grupuara sipas aktivitetit të synuar):
-Parcela ndërtimore që do t'i nënshtrohen tjetërsimit me ankand publik;
-Parcela ndërtimi që do t'i nënshtrohen qirasë afatgjatë me tender publik;
-Parcela ndërtimi që do t'i nënshtrohen qirasë afatshkurtër me ankand publik;
-Parcela ndërtimi që do të jenë objekt shfrytëzimi për dhënien e koncesionit ose partneritetit publik privat.

4.Strategjia e marketingut për promovimin e tokës ndërtimore që është objekt i këtij programi:
-Përcaktimi i një grupi të synuar për grupe të veçanta parcelash ndërtimore;
-Përcaktimi i qasjeve, mjeteve dhe kanaleve më efektive të marketingut;
-Përcaktimi i fushës dhe kostove që lidhen me zbatimin e strategjisë së marketingut;
-Personat përgjegjës për zbatimin e strategjisë së marketingut.

Neni 3

Dinamika e realizimit të Programit:
-Numri i raundeve për shpalljen e njoftimeve, periudha kohore për shpalljen e njoftimeve dhe shpërndarjen e parcelave ndërtimore sipas raundeve;
-Përcaktimi i kushteve të tenderit;
-Personat përgjegjës për zbatimin e Programit.

Neni 4

Vlerësimi i hyrjeve financiare në bazë të realizimit të Programit (ana e të ardhurave të programit);

Vlerësimi i burimeve financiare të nevojshme për zbatimin e programit (ana e shpenzimeve të Programit) Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Neni 5

Prezantimi:

- Pjesa e përgjithshëm;
- Me miratimin e Ligjit për Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e R.M. Nr. 15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16 dhe 190/16 dhe Gazeta Zyrtare e R.M.V 275/19) tokën ndërtimore mund ta kenë Republika e Maqedonisë së Veriut, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit, personat juridikë dhe fizikë vendas dhe të huaj;
- Pronësia e tokës ndërtimore krijon të drejta dhe detyrime;
- Pronësia e tokës ndërtimore përfshin të drejtën për të ndërtuar mbi tokë;
- Vendimin për marrjen në pronësi të tokës ndërtimore për komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit e miraton Këshilli;
- Pronësia e komunave mundëson këto të drejta: ndërtimin, shfrytëzimin, kalimin e së drejtës për ndërtim personave të tjerë dhe tjetërsimin e tokës ndërtimore. Toka ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut menaxhohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Tokën ndërtimore e destinuar për përdorim të përgjithshëm mund ta shfrytëzojnë të gjithë personat juridikë dhe fizikë, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund t'ua transferojë të drejtën e shfrytëzimit komunave;
- Pronësia e tokës ndërtimore mbulon sipërfaqen e saj dhe gjithçka që është e lidhur në mënyrë të përhershme me të dhe ndodhet mbi ose nën sipërfaqe;
- Toka ndërtimore është e mirë me interes të përgjithshëm për Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe rregullimi i tokës ndërtimore është me interes publik;
- Toka ndërtimore mund të jetë e ndërtuar dhe e pandërtuar, e rregulluar dhe e parregulluar;
- Tokë ndërtimore e ndërtuar është trualli në të cilin është ndërtuar objekt me karakter të përhershëm dhe toka që shërben për shfrytëzim të rregullt të objektit brenda kufijve të parcelës ndërtimore;
- Toka ndërtimore e organizuar është tokë e pajisur me infrastrukturë komunale, ndërsa tokë e paorganizuar është toka në të cilën nuk është ndërtuar infrastrukturë komunale;
- Tokë ndërtimi është trualli që planifikohet me plan urbanistik ose dokument urbanistik;

- Parcela ndërtimore është pjesë e tokës ndërtimore kufijtë e së cilës përcaktohen me plan urbanistik ose dokument urbanistik dhe mund të përbëhet nga një, pjesë ose disa ngastra kadastrale;
- Objekt me karakter të përhershëm është objekti i ndërtuar me dokumentacion (leje ndërtimi) dhe i regjistruar në librat publik të pasurive të paluajtshme;
- Objekti me karakter të përkohshëm është objekti i vendosur me miratim për vendosje deri në realizimin e planit urban ose dokumentacionit urbanistik;
- Ndërtesat e përkohshme nuk janë pjesë e tokës ndërtimore dhe në bazë të tyre nuk mund të fitohet pronësia e tokës ndërtimore;
- Objekt infrastrukturor është ndërtesa nëntokësore ose mbitokësore për instalimet e infrastrukturës komunale;
- Tregtia me tokën ndërtimore është e lirë;
- Prona e tokës ndërtimore e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të tjetërsohet, të jepet në shfrytëzim (koncesion ose partneritet publik privat), të jepet me qira afatgjatë dhe afatshkurtër, të shkëmbehet ose të vendosen të drejta të tjera reale.

Neni 6

1. Shtrirja hapësinore dhe lënda e Programit:
- Lënda e programit është administrimi i tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendndodhje në territorin e komunës së Jegunovcit , e përcaktuar sipas organizimit territorial të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit kalendarik 2023;
- Faktor i rëndësishëm në këtë procedurë është kategoria e plan urbanistik, pra plan urbanistik në bazë të të cilave mund të jepet leja e ndërtimit;
- Gjatë Programit Vjetor është paraparë që subjekt i menaxhimit të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut të jenë parcelat ndërtimore që ndodhen në territoret e këtyre vendbanimeve: Podbreg ;
- Parcelat ndërtimore në vendbanimin Podbreg, që është objekt i këtij programi, janë të mbuluara me Planin Urbanistik për fshatin Podbreg me përpunimin e blloqeve 5, 7 dhe 9, komuna e Jegunovcit, të miratuar me Vendimin nr. 07-1470/4 të datës 24.09.2014 nga Këshilli i Komunës së Jegunovcit.

Neni 7

Bazat për krijimin e Programit

1. 3 baza ligjore:
- Baza ligjore e Programit të Menaxhimit të Tokës Ndërtimore janë: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 05/02), Ligji për Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 15/ 15, 98/ 15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16 dhe 190/16 dhe Gazeta zyrtare e RMV nr .
2. Dokumentet bazë të planifikimit:
- Programi për zhvillimin e planeve urbanistike të Jegunovcit për vitin 2024;
- Përfshirja territoriale e komunës së Jegunovcit përbëhet nga 17 vendbanime. Për të siguruar rregullimin dhe humanizimin e hapësirës, si dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit dhe natyrës, për vitin 2025, përgatitja e planeve urbanistike për fshatin për të cilat ka akte të përgjithshme për fshatin, ndërsa për ato jashtë fushëveprimit planifikues për të gjitha vendet e banuara, është planifikuar prodhimi i synuar i planet urbanistike jashtë vendbanimit dhe projektet urbanistike;

- Me projekte urbanistike, rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës mund të bëhet në përputhje me Ligjin për Urbanistikë (Gazeta Zyrtare e R.M.V nr. 32/20).

Neni 8

Personat e përfshirë në zhvillimin e Programit:
- Darko Spasoski, ekonomist i diplomuar;
- Stojançe Antovski, i diplomuar në administratë publike;
- Mlladenço Jovanovski, teknik gjeodez ;
- Igor Filipovski, inxhinier i diplomuar arkitekt.

Neni 9

KRYETARËT E PROGRAMIT

1. Objektivat e përgjithshme të programit:

- Sigurimi i kushteve për zhvillim socio-ekonomik të komunës duke krijuar kushte hapësinore për zhvillim;
- Objektivat specifike të programit sipas vendbanimeve, blloqeve urbane dhe lokaliteteve;
- Qytetarët e interesuar për ndërtimin e objekteve të tyre për kryerjen e aktiviteteve mund të kuptojnë nevojën e tyre dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në zhvillimin e vendbanimit/lokalitetit, shfrytëzimin e burimeve lokale, punësimin e njerëzve, sigurimin e kushteve më të mira të jetesës etj.

Neni 10

Shtrirja dhe pasqyra e tokës ndërtimore objekt i programit:
- Parcelat ndërtimore në vendbanimin Podbreg, që është objekt i këtij programi, janë të mbuluara me Planin Urbanistik për fshatin Podbreg me përpunimin e blloqeve 5, 7 dhe 9, komuna e Jegunovcit, të miratuar me Vendimin nr. 07-1470/4 të datës 24.09.2014 nga Këshilli i Komunës së Jegunovcit.

Neni 11

- Realizimi i Planit Urbanistik për fshatin Podbreg me zhvillimin e blloqeve 5, 7 dhe 9, komuna e Jegunovcit do të jetë në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik me investime të reja dhe punësim, me kusht që detyrimet ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe aplikimin e parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Madhësia e fushës planifikuese për bllokun 5 në fshat. Podbreg është 53732 m2;
- Madhësia e fushës planifikuese për bllokun 7 në fshat. Podbreg është 27694 m2;
- Madhësia e fushës planifikuese për bllokun 9 në fshat. Podbreg është 7992 m2;
- Arsyeja e përgatitjes së planit është zgjidhja e parcelimit të hapësirës dhe objekteve sipas situatës ekzistuese, modernizimi i një pjese të objekteve ekzistuese, si dhe shfrytëzimi dhe rregullimi më racional i hapësirës dhe qarkullimit brenda blloqeve dhe interpolimi i përmbajtje të reja të imponuara nga koha, në përputhje me rregulloret ligjore për urbanizimin e hapësirës;
- Kjo zonë është e lidhur me pjesët tjera të vendit përmes rrugës rajonale R2242 - Zhelinë (lidhja me A2) - Jegunovc (lidhja me 2234).

Neni 12

Shqyrtim i detajuar i parcelave ndërtimore

A) Parcela ndërtimore (bashkëngjitje grafike M=1:1000) që do t'i nënshtrohen tjetërsimit nëpërmjet ankandit publik me tabela përkatëse dhe informacionin e nevojshëm:
Plani urbanistik për fshatin Podbreg me zhvillim të bllokut 5, komuna e Jegunovcit, miratuar me Vendim nr. 07-1470/4 të datës 24.09.2014 nga Këshilli i Komunës së Jegunovcit.

Shtojca grafike - Blloku 5




Tabela me tregues numerikë për parcelat ndërtimore në bllokun 5

Број на парцела	Површина на парцела	Површина за градба $м^2$	Бруто разв. корис. повр.	Вис. на објект до венец	катност	Намена на објекти	компатиб. намени	процент на компат. намени	Бр. на потр. паркинг м.
1	3467	1848	3696	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	37
2	3140	2003	4006	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	40
3	3842	2688	5376	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	54
4	3641	2356	4712	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	47
5	4751	3229	6458	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	65
6	3677	2300	4600	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	46
7	4606	2876	5752	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	57
8	5747	3795	7590	10.20	П + 1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	76

Shqyrtim i detajuar i parcelave ndërtimore

A) Plani urbanistik për fshatin Podbreg me zhvillim të bllokut 7, komuna e Jegunovcit, miratuar me Vendim nr. 07-1470/4 të datës 24.09.2014 nga Këshilli i Komunës së Jegunovcit.

Shtojca grafike - Blloku 7




Tabela me tregues numerikë për parcelat ndërtimore në bllokun 7

Број на парцела	Површина на парцела	Површина за градба $м^2$	Бруто разв. корис. повр.	Вис. на објект до венец	катност	Намена на објекти	компатиб. намени	процент на компат. намени	Бр.на потр. паркинг м.
1	5315	1717	3434	10.20	П+1	Г2,Г3,Г4	Б1,Б2,Г3,Г4,Д2	30%	34

Shqyrtim i detajuar i parcelave ndërtimore

A) Plani urbanistik për fshatin Podbreg me zhvillim të bllokut 9, komuna e Jegunovcit, miratuar me Vendim nr. 07-1470/4 të datës 24.09.2014 nga Këshilli i Komunës së Jegunovcit.

Shtojca grafike - Blloku 9




Tabela me tregues numerikë për parcelat ndërtimore në bllokun 9

Број на парцела	Површина на парцела	Површина за градба м²	Бруто разв. корис. повр.	Вис. на објект до венец	катност	Намена на објекти	компатиб. намени	процент на компат. намени	Бр.на потр. паркинг м.
1	7993	4760	4760	4.50	П	Д3	А4,Б1,Б2,Б3,Б6,В3	40%	

Neni 13

Strategjia e marketingut dhe promovimit të tokës ndërtimore që është objekt i këtij programi:

1. Përcaktimi i grupeve të synuara për grupe të veçanta për parcelat ndërtimore;
- Grupi i synuar për zonën e dedikuar A1 - strehim në shtëpi banimi; çifte të reja të martuara, qytetarë me më pak fuqi blerëse, qytetarë me kushte nën standarde të jetesës;
- Grupi i synuar për zonën e dedikuar B5 - kompleks hotelier: investitorë vendas dhe të huaj për ndërtimin e njësive të mëdha katering;
- Grupi i synuar për zonën e dedikuar G2 - industria e lehtë dhe jo ndotëse: investitorë vendas dhe të huaj për zgjerimin e objekteve ekzistuese industriale, blerjen e qendrave të shpërndarjes për prodhim dhe magazinim;
- Grupi i synuar për zonën e dedikuar GZ - shërbimet: investitorë vendas dhe të huaj mirëmbajtje dhe riparim të pajisjeve dhe produkteve industriale si shërbime për makina dhe automjete të tjera, makineri, vegla dhe instrumente, pastrim kimik, etj.;
- Grupi i synuar për zonën e dedikuar G4 - magazina: investitorë vendas dhe të huaj për ruajtjen e mallrave në një hapësirë të hapur ose të mbyllur, në kushte të veçanta magazinimi, mbetje, tregje auto;

2. Përcaktimi i qasjeve, mjeteve dhe kanaleve më efektive të marketingut Krijimi, përmirësimi dhe zgjerimi i faqes së internetit të komunës së Jegunovcit, zhvillimi i infrastrukturës për teknologji informative, një faqe interneti interaktive dhe interneti, përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promovuese, prezantimi dhe lobimi në komunë, prezantimi mediatik i potencialeve dhe resurseve ekonomike të komunës së Jegunovcit etj.

Neni 14

Dinamika e zbatimit të programit:

1. Numri i raundeve për afishimin e njoftimeve, periudha kohore për shpalljen e njoftimeve, shpërndarja e parcelave ndërtimore sipas raundeve;
